VENDIM
Nr.1, datë 8.2.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
lvi Myrtja	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtare	e Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese

me sekretare Drita Filto, më datat 22.12.1992, 30.12.1992 dhe 8.2.1993, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 14/2 që i përket:

KëRKUES: Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste i përfaqësuar në gjyq nga Bashkim Caka e Vladimir Metani.

OBJEKTI

Anulimi i vendimit të Kuvendit Popullor datë 23.10.1992, për heqjen e imunitetit të deputetit Ilir Meta, si antikushtetues.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relacionin e çështjes,

VËREN:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar anulimin e vendimit datë 23.10.1992 të Kuvendit Popullor, me të cilin i është hequr imuniteti deputetit Ilir Rexhep Meta.

Heqja e imunitetit të deputetit Ilir Meta është bërë mbi kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme, në të cilën parashikohej se gjatë zhvillimit të hetimeve kundër një numri personash të qytetit të Poliçanit për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë, kishin dalë të dhëna edhe për deputetin Ilir Meta, për shpërdorimin e detyrës nga ana e tij, vepër kjo që parashikohej nga neni 106 i Kodit Penal.

Në kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, pretendohet se në veprimet e deputetit Ilir Meta nuk ka elementë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal e as të një vepre tjetër penale dhe se këto veprime ai i ka kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij si deputet.

Më datat 21, 22 e 23 tetor 1992, Kuvendi Popullor ka shqyrtuar kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme për heqjen e imunitetit të deputetit Ilir Meta dhe në mbështetje të Ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me Vendimin e tij nr.235, datë 23.10.1992, i ka hequr imunitetin deputetit Ilir Meta.

Sipas paragrafit të tretë të nenit 22 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, deputetët e Kuvendit Popullor gëzojnë imunitet, ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen apo të ndiqen penalisht pa pëlqimin e Kuvendit Popullor, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë.

Kjo normë, përbën në vetvete një përjashtim nga parimi i përgjithshëm i barazisë së shtetasve para ligjit. Ai është një privilegj i Parlamentit si mbajtës i sovranitetit të popullit dhe shërben si një mjet mbrojtjeje ndaj presioneve apo shantazheve që mund t'i bëhen atij.

Kur Kuvendit Popullor i paraqitet nga ana e organeve të drejtësisë kërkesa për lejimin e ndjekjeve penale dhe të zhvillimit të hetimeve kundër një apo disa deputetëve të caktuar, ka të drejtë të çmojë vetë oportunitetine dhënies apo të mosdhënies së autorizimit pa qenë aspak i detyruar t'i hyjë çështjes në themel dhe të kryejë veprime që janë në kompetencat e organeve të hetimit apo të gjykimit.

Kështu Kuvendi Popullor, në këto raste, shikon vetëm nëse dokumentat e paraqitura janë ose jo të mjaftueshme për të çmuar nëse kërkesa është bërë e argumentuar dhe nëse pas kësaj nuk fshihen motive politike, që ajo nuk bëhet me qëllim për të ushtruar presion ndaj parlamentit nga ana e organeve të tjera.

Heqja ose jo e imunitetit të deputetit dhe dhënia ose jo e autorizimit organeve të drejtësisë për të zhvilluar hetime kundër tij është një çështje që varet tërësisht nga vlerësimi i Parlamentit dhe një e drejtë ekskluzive e tij, prandaj këto veprime nuk i shtrohen ankimit apo kontrollit të një organi tjetër shtetëror.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2 dhe të neneve 25.e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste të Shqipërisë, kundër vendimit nr.235, datë 23.10.1992 të Kuvendit Popullor për heqjen e imunitetit të deputetit Ilir Meta.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.